

V E N D I M

I Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "HORIZON INVEST" shpk"

Nr. 2 datë 30.06.2025

Sot më datë, 30.06.2025 në orën 12.00, në selinë e shoqërisë me adresë: Njësia Administrative Petrelë, Fshati Stërmas.1034, Tiranë, është mbledhur Asambleja e Përgjithshme e ortakëve të Shoqërisë "Horizon Invest shpk", shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Regjistrin Tregetar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT: M51425004E për të diskutuar dhe vendosur në lidhje me rendin e ditës si më poshtë vijon:

Rritja e Kapitalit të Rregjistruar të Shoqërisë "Horizon Invest" shpk me kontribute në para nga ortakët ekzistues të shoqërisë, në përpjestim me kuotat që zotërojnë aktualisht në kapitalin e shoqërisë.

Të tjera çështje.

Në këtë Asamble morën pjesë të tre ortakët e shoqërisë që përbëjnë 100% të kuotave të kapitalit,

- Ortaku Z. Artan Dulaku, zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson 37.5% të kapitalit të shoqërisë,
- Ortaku Z. Genci Dulaku, zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson 37.5% të kapitalit të shoqërisë dhe,
- Ortaku Z. Erjon Harizi, zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson 25% të kapitalit të shoqërisë.

Duke qënë se është plotësuar kuorumi dhe shumica vendim-marrëse për vendimet e cilësuara, Asambleja e bazuar në të drejtat dhe detyrimet që i jep ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe statuti i shoqërisë, pasi mori në shqyrtim projektin e zmadhimit të kapitalit të regjistruar paraqitur nga administratori i saj, në perfundim,


Vendosi:

1. Mbështetur në analizën e gjëndjes financiare aktuale dhe objektivave për zgjerimin e aktivitetit, të miratojë zmadhimin në para të kapitalit të regjistruar të shoqërisë për shumën 133,300 Euro ose 13,074,064 lekë, me kontributin e ortakëve ekzistues, në përpjestim me kuotat që zotërojnë në kapitalin e regjistruar, ndarë si më poshtë:

- Z. Artan Dulaku, zotërues i kuotës 37,5 %, do të kontribojë me shumën 50,000 Euro ose 4,904,000 lekë,
- Z. Genci Dulaku, zotërues i kuotës 37,5 %, do të kontribojë me shumën 50,000 Euro ose 4,904,000 lekë,
- Z. Erjon Harizi, zotërues i kuotës 25 %, do të kontribojë me shumën 33.300 Euro ose 3,266,064 lekë,

Horizon Invest SHPK

Adresa: Tirane, Petrele Stermas, Njësia Administrative Petrele, Fshati Stermas.1034, Tiranë Cel: 0694023018, E-mail: horizoninvestshpk@gmail.com, NIPT: M51425004E



Sipas shumave përkatëse kontributet do të derdhen menjëherë në llogaritë bankare të shoqërisë.

2. Ndryshimin e nenit 7 të statutit të shoqërisë "Kapitali i Shoqërisë", që tani lexohet si më poshtë:

"Kapitali themeltar i regjistruar i shoqërisë është 13,174,064 leke, i ndarë në 3 (tre) kuota kapitali dhe zotërohet nga ortakët:

- Z. Artan Dulaku, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme me 4,941,500 lekë, që përbën 37.5% të kapitalit të regjistruar.
- Z. Genci Dulaku, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme me 4,941,500 lekë, që përbën 37.5% të kapitalit të regjistruar.
- Z. Erjon Harizi, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme me 3,291,064 lekë, që përbën 25% të kapitalit të regjistruar".

3. Të ngarkojë administratorin e shoqërisë, vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar prej tij, për depozitimin e këtij vendimi në rregjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) brenda afateve ligjore të përcaktuara.

4. Duke mos pasur çështje të tjera për diskutim, Asambleja mbyllet me nënshkrimin e këtij dokumenti, i cili u hartua në 4(katër) kopje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve "HORIZON INVEST" Sh.p.k

Z. Artan Dulaku



Z. Genci Dulaku



Z. Erjon Harizi

